



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9753 Prot.

Roskovec, më 01.11 2022

VENDIM

NR. 76 .DATË 31.10 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN SHTATOR 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.09.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 8913/1 Prot.

Roskovec, më 03 . 10 .2022

Procesverbal Nr.10

-I mbajtur sot, date 30.09.2022, ora 12³⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2022.
5. Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për negociimin me Bashkitë e Qarkut Fier, për marrjen në dorëzim të impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane Fier, sipas detyrimeve të kontratës koncesionare.
6. Për miratimin e ndryshimeve në formularin e vetëdeklarimit për fillim punimesh të mirëmbajtjes së zakonshme.
7. Për miratim të nismës për ndryshimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec.
8. Për miratimin e dokumentit të PBA të rishikuar 2023-2025.
9. Për miratim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
10. Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në Nr.1012 datë 11.12.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunes Kuman, Qarku Fier dhe VKB-së Nr.50 datë 29.06.2020 "Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman, Bashkia Roskovec".
11. Raport i monitorimit për 4-mujorin e II viti 2022.
12. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 12⁰⁵

Keshilltaret prezent: A.Kola, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret që mungojnë: V.Mata, Rr.Hazizi, T.Kuka, G.Hoxha, A.Sheme, B.Toska, D.Hoxha.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari K.Lushka, Sek. e Përgjithshme Dr.Finances, Dr.Urbanistikes, P/Z/Sherbimit Social, Kordinatori i Bashkive te Forta.

Me plotësimin e kuorumit, kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 12 keshilltaret. Kryetari i falenderon keshilltaret për prezencën dhe fillon me mbledhjen.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Gusht 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin ne lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar. Sqaron se vetem nje vendim ishte me karakter normativ i cili u miratua nga Prefektura.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

4. Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Gusht 2022.

P/Z/Ndhimes Ekonomike Sidorela sqaron se kete muaj nuk ka ndryshime. Elmazi-kryeministri po flet se ndihmat do rriten, kur do rriten keto? Sidorela-akoma nuk na ka ardhur shkresa. Vjollca-ka shtesa tek 6%, kane bere kerkese keto familje? Po nese nje familje eshte ne nevojje dhe ka emigrant, kush e ka verifikuar? Sidorela-e ka verifikuar administratorja e ndihmes ekonomike te zones perkatese. Vjollca-heren tjetër dua nje informacion per kerkesat qe kane bere per 6%, ju lutem verifikoni emrat kush merr ndihme ekonomike, dhe gjithë pjestaret e tyre te familjes, emrat kush merr ndihme ekonomike, se kemi pasur dhe emigrant, kush i ka firmosur per ta. Pra emrat e njesise Kurjan te 6% dhe ndihmes ekonomike. Elmazi-une e di qe te gjithë ata qe nuk fitojne ne ndihme ekonomike, bashkia i fut tek 6%, sistemi nuk te le te gabosh, por ankesat duhet ti bejme sipas kuadrit ligjor. Leksi-ceshtja e emigranteve ketu nuk ka vend, sepse nuk te lejon sistemi, kemi 3 vjet qe merremi dhe ligji ste le te gabosh. Bujari-ne njesine administrative Kuman ka aplikime aktualisht ne ndihme ekonomike? dhe pse nuk perfitojne familje te tjera? Sidorela-kete muaj vetem 2 familje aplikuan, nuk kane ardhur per aplikim familje te tjera. Nuk ka me diskutime. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

5. Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për negocimin me Bashkitë e Qarkut Fier, për marrjen në dorëzim të impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane Fier, sipas detyrimeve të kontratës koncesionare.

Delina Hoxha sqaron projektin. Pas miratimit te ketij projekti, kryetarja do filloje negocimin me bashkite e qarkut, sipas detyrimeve ne kontraten koncesionare "Per ndertimin e administrimit e impjantit te trajtimit te mbetjeve urbane te qarkut Fier, per vazhdimin e procedurave ligjore per dorzimin e impjantit te trajtimit te mbetjeve urbane Fier tek bashkite e qarkut. Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

6. Për miratimin e ndryshimeve në formularin e vetëdeklarimit për fillim punimesh të mirëmbajtjes së zakonshme.

Dr. Urbanistikes Eneida Hoxha sqaron projektin dhe ndryshimet qe ka pasur ne VKM. Ju kemi paraqitur formularin e vetedeklarimit per fillim punimesh qe nuk kerkojne pajisjen me leje ndertimi. Bujari- cfare ndryshimesh jane bere ne formular? Leksi-po te plotesosh te gjithen apo ngjysmen njelloj eshte leja? Eneida sqaron ne lidhje me pyetjet e bera si me siper. Eneida sqaron se ky formular po miratohet sot per here te pare dhe sipas ndryshimeve qe jane bere ne vkm. Sqaron per pyetjen e Leksit se leja nuk eshte njelloje. Hidhet ne votim formulari i vetedeklarimit per fillim punimesh qe nuk kerkojne pajisjen me leje ndertimi sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

7. Për miratim të nismës për ndryshimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec.

Eneida sqaron se PPV ka nevojje per disa ndryshime ne disa njesi strukturore. Sqaron dhe kerkesen e qytetarit Lavdimir Kurtaj, ofron te ndertoje terminalin nese merr lejen per ndertimin e vet. Bujari-

ai është i licensuar,i ligjeruar qe te jemi te rregullt?Eneida-ky është hapi i pare,nisja e nismes per ndryshimin e PPV.Elmazi-pajtohëm me keshilltarin,ne duhet te kishim nje informacion me te detajuar per kete projekt.Eneida sqaron se kjo është vetem nisma qe po merret per ndryshimin e PPV,njelloje sic ju keni miratuar para disa kohesh ndryshimin e PPV per pallatin 6 katesh tek ish-SMT-ja.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimmisht me 12 vota pro.

8.Per miratimin e dokumentit te PBA te rishikuar 2023-2025.

Dr.Finances S.Çepele sqaron se ne kete materjal ne kemi perfshire te gjitha ndryshimet qe kemi bere keto muaj,i kemi pasqyruar ne kete materjal.Hekurani-kur do filloj catia e shkolles se Kumanit?Selmani-eshte ne proces tenderimi,me lidhjen e kontrates do filloje zbatimi.Hidhet ne votim dokumenti i PBA 2023-2025 i rishikuar sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimmisht me 12 vota pro.

9.Per miratim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2022.

Dr.finances sqaron fondet e parashikuara ne projekt.Pika e pare ka te bej me fondin per rritjen e pagave per arsimin parashkollor ne baze te shkreses qe na ka ardhur nga Ministria.Pika e dyte ka te bej me marrjen e 2 ambjenteve me qera per tu perdorur per ambjente shkollore per nxenesit e shkolles “5 Deshmoret”sepse shkolla e tyre do rikonstruktohet.Vjollca-eshte bere gati ambjenti i shkolles?Leksi-sa perqind u rritet paga edukatoreve?Selmani 7-10 %.Bujari-si do funksionojë kjo bilete,dhe si do jete transporti,ku do shkojne keto leke?Selmani-transporti do te kryhet me ata qe jane te licensuar per transport publik,ne do i mbulojme 30% te shpenzimeve te vleres se biletës sipas linjave qe keni ne projekt.Bujari-ky 30% kujt i kalon familjarit apo firmes se transportit?Selmani-do i kaloje familjarit.Mateo-ka qene pak problematike pagesa e kesaj 30%,me poste apo me banke,se jo te gjithë kane numer llogarie.Vjollca-femijet e fshatit Mbers jane te harruar.Selmani-femijet e Mbersit e marrin nga Drejtoria Arsimore.Vjollca-kerkoje per gjimnazistet e Mbersit qe ven ne Kurjan,porosi per mbledhjen e ardhshme kerkesa qe ngriti Vjollca per rimbursimin e gjimnazisteve te Mbersit.Dr.Finances sqaron se kete projekt-vendim e kemi ndare ne dy projekte,per arsye se vetem njera pike e projektit është me karakter normative dhe qe do konfirmohet nga Prefektura,pikat e tjera nuk jane normative.Pra do jene 2 vendime.Hidhet ne votim projekt-vendimi per miratim fondesh shtese ne buxhetin e bashkise per vitin 2022 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimmisht me 12 vota pro. Hidhet ne votim projekt-vendimi per miratim fondesh ne buxhetin e bashkise per vitin 2022 sipas materjalit dhe miratohet unanimmisht me 12 vota pro.(2 vendime)

10.Për përditësim në listën e inventarit,miratuar me VKM-në Nr.1012 datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunes Kuman,Qarku Fier dhe VKB-së Nr.50 datë 29.06.2020 “Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman,Bashkia Roskovec”.

Eneida Hoxha sqaron projektin.Sqaron token dhe vendodhjen e saj,qe i shtohet inventarit te Njesise Administrative Kuman.Ajo është toke pa frut.Alketi-si është kjo planvendosje,pronat qe jane ngjitur jane numrat rendor me radhe?Eneida sqaron se numrat skane te bejne me radhen,por me ndarjen e parceses.Alketi pyet per nje kerkesë per rindarje parcele,por topografi thote ne baze te pretendimit tend.Elmazi-kjo nuk është ne rendin e dites,bej kerkesë.Hidhet ne votim perditësimi i listes se inventarit te pronave te paluajtshme shtetërore ne territorin e Njesise Administrative Kuman sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimmisht me 12 vota pro.

11.Raport i monitorimit per 4-mujorin e II viti 2022.

Dr. Finances sqaron raportin e monitorimit per 4-mujorin e II viti 2022. Sqaron pasqyrat perkatese sipas anekseve 1,2 dhe 5 te cilat i jane bashkengjitur raportit. Ky raport eshte dhe nje detyrim ligjor per tju paraqitur juve. Nuk ka diskutime dhe pyetje.

12. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Borana Kuka si kryetare e aleances se grave te keshillit te bashkise Roskovec, informon keshillin rreth aktivitetit qe ka zhvilluar kjo aleance dhe nismat e vendimet qe kjo aleance ka ndermarr. Aleanca ka nisur nje fushate per 2023 per keshilltare ne zgjedhjet e ardhshme. Lexon emrat qe ka propozuar aleanca nga takimet e zhvilluara dhe emrat qe jane propozuar per keshilltare nga 3 forcat politike. Roberti-falenderime per kryetaren e bashkise. Falenderon keshillin. Ve ne dukje se komisionet duhet te mblidhen me shpesh, jo vetem ne projekte te rendesishme. Alketi-problem banjot e shkolles 9-vjecare Alush Grepcka, ngjysmat nuk funksionojne, dhe shkalleve te shkolles tu vihet gome se jane te rreshkitshme. Durimi-pse qytetari duhet te presi deri ne oren 2 per te takuar nje punonjes te administrates? Pse dera e bashkise ruhet me 6 polica bashkiak, kush eshte roli i policise bashkiake, a jane te trajnuar, a jane me arsim? Fshati Mbers ka 9 muaj pa kryetar fshati, pse nuk ka akoma nje kryetar? Vjollca-ne rruge nga Roskoveci deri lart ne Mbers jane vendosur shtyllat e reja elektrike, shtyllat e vjetra qe kane qene jane shtremberuar te gjitha dhe po varen. Nuk ka me diskutime. Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

